

Ligjeratat e ardhëshme,  
Kreu: IX;X

**IX. PARAJA DHE BANKA QENDRORE**  
**X. INFLACIONI**

## Për çka na shërben paraja?

- Paraja i ndihmon pronaret, sepse pronari mund t'i përdor ato atje ku të dëshirojë ose ku ata kanë nevojë (të paguhen punëtorët, për pushime, për studime, për shkollimin e fëmijëve, për të blerë shtëpi, banesa, makina, tesha etj.). Paraja duke kaluar nga dora në dorë stimulon prodhimin dhe tregtimin dhe realizon alokimin efikas të resurseve.
- Në këtë kapitull fillojmë me prezantimin dhe rolin e parasë në ekonomi, vazhdojmë me funksionet e saj, krijimi i parave nga sistemi bankar, Bankën Qendrore dhe funksionet e saja.

# KUPTIMI I PARASË

- Paraja është mjeti kryesor i këmbimit. Ajo është indikator monetar i cili determinon prodhimin, punësimin, nivelin e çmimeve, normat e interesit, investimet dhe shumë variabla të tjera ekonomike.
- Në paranë letër, vlera nominale nuk është e detyruar t'i përgjigjet vlerës substanciale të saj, kështu pra ajo bëhet surrogate e parasë metalike (arit).
- ***Paraja është mjet ligjor i pagesave në një ekonomi kombëtare e më gjerë. Ajo është dekretuar nga shteti dhe ka emër, stemën, simbolet dhe elemente të tjera.***
- Denari, Leku, Euroja, Franga zvicerane, Dollari, janë para të Maqedonisë, Shqipërisë, Eurozonës, Zvicrës, dhe SHBA-ve.

# Funksionet e parasë

- Paraja me funksionet e saj ka rëndësi të veçantë për rrjedhat ekonomike.

*I. Paraja si masë e vlerës*

*II. Paraja si mjet qarkullimi*

*III. Paraja si ruajtës i pasurisë (thesar)*

*IV. Paraja si mjet pagese*

*V. Paraja si mjet likuiditeti*

# MASA MONETARE

- **Sasia e parasë** në një ekonomi ka rëndësi të veçantë, sepse ajo determinon kahet dhe intensitetin e shumë indikatorëve makroekonomik. Për rrjedha stabile ekonomike, nevojitet sasia optimale e parasë, e cila mundëson transaksione ekonomike **pa tendenca inflatore**.
- Në ekonominë më të fuqishme të botës, në SHBA, fondi i parave matet me katër agregat monetar. Ato janë: M0, M1, M2 dhe M3.
- **M0 - prezanton paratë e gatshme dhe monedhat.**
- **M1 - përfshin paratë e gatshme dhe monedhat (M0),** dollarin i cili qarkullon jashtë shtetit, çeket e udhëtarëve, depozitat e paafatizuara dhe depozitat e tjera.
- **M2 - përfshin të gjitha ofertat monetare të M0 dhe M1.**  
*Si mjete kryesore të M2 janë depozitat e kursimeve me afat fiks me vlerë nën 1.000.000 \$, si dhe investimet afatshkurtër në tregun e letrave me vlerë.*
- **M3 - përfshin ofertat e sipërpërmendura (M0, M1 dhe M2) plus depozitat me afat të gjatë,** me vlerë mbi 1.000.000 \$ dhe fondet institucionale.

- Në sistemet monetare të ekonomisë shqiptare dhe disa ekonomive të tjera, fondi i parave matet me agregatet monetar, si më poshtë:
- **M1 – përfshin paratë kesh dhe të gjitha mjetet tjera likuide të cilat shpejt dhe në çdo kohë mund të realizojnë transaksione të ndryshme.**
- **M2 – përfshin M1 dhe forma të tjera të aktiveve të cilat nuk janë para të transaksioneve, por mund të kthehen në shpejtësi si të tilla (depozitat afatshkurtër)**
- **M3 – përfshin M2 dhe depozitat e kursimeve në periudha afatgjata kohore.**
- **M4 – përfshin M3 dhe aktivet tjera afatgjate, si p.sh., triskat e thesarit.**

# RËNDËSIA E OFERTËS MONETARE NË RRJEDHAT EKONOMIKE

- Oferta monetare është instrument i fuqishëm i Bankës Qendrore, me anë të së cilës arrihen objektivat makroekonomike.
- *Ekonomistët pajtohen se efektet e sipërpërmendura të politikës ekspansioniste monetare i takojnë periudhës afatshkurtër dhe në periudha afatgjata kohore, rritja e ofertës monetare rezulton me rritjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve (inflacionit).*
- Sipas monetristëve oferta e rritur e parasë rezulton jo vetëm me rritjen e kërkesës agregate, por dhe të nivelit të përgjithshëm të çmimeve. Oferta e parasë në një ekonomi kombëtare varet edhe nga shpejtësia e qarkullimit të saj. Nga ajo që u cek më sipër, mund të prezantojmë shprehjen matematikore të monetaristëve, ajo është:

$$MV = PQ.$$

- M – tregon ofertën e parasë,
- V – shpejtësinë e qarkullimit të parasë,
- P - nivelin e çmimeve dhe
- Q – sasinë e përgjithshme të të mirave dhe shërbimeve në një ekonomi.

Nga kjo mund të vërejmë se **ana e djathtë (PQ)** tregon PBB nominal dhe **ana e majtë (MV)** tregon ofertën dhe shpejtësinë e parasë

- Oferta e rritur monetare shoqërohet me reduktimin e normave të interesit, të cilat inkurajojnë investimet dhe konsumin e amvisërive. Normat e ulëta të interesit do të stimulojnë më së shumti sektorët më të ndjeshëm, siç është ai i strehimit.
- ***Ekonomistët pajtohen se efektet e sipërpërmendura të politikës ekspansioniste monetare i takojnë periudhës afatshkurtër dhe në periudha afatgjata kohore, rritja e ofertës monetare rezulton me rritjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve (inflacionit).***
- Sipas monetaristëve, faktorët monetar kanë rrolin kryesor në ekonomi, sipas tyre oferta e parasë dhe PBB nominal kanë lidhje të forta korelative. Me fjalë të tjera, rritja e ofertës monetare rrit kërkesën agregate dhe rritja e kësaj të fundit rrit PBB nominal dhe anasjelltas.



- *Me rezerva të detyrueshme kuptojmë pjesën e depozitave të bankave të nivelit të dytë (Bankat Komerciale) të cilat nuk huazohen, por mbahen rezervë te Banka Qendrore.*
- $TD = ID \times 1/RR \times 100.$

### **Shenjat paraqesin:**

- **TD** = Depozitat e përgjithshme,
- **ID** = Depozitat fillestare dhe
- **RR** = Normat e rezervave të detyrueshme.

Duke zëvendësuar të dhënat e tabelës së

fitojmë multiplikarin  $TD = 1.000.000 \times 1/10 \times 100 = 1.000.000 \times 10 = 10.000.000 \$.$

- **Bankat** janë institucione financiare të cilat mobilizojnë mjetet e lira monetare dhe i plasojnë në formë të kredisë, Me fjalë të tjera, bankat mbledhin paratë nga ato të cilët kursejnë (depozituesit) dhe ua shpërndajnë atyre të cilët kanë nevojë për to. Bankat për të rrit fitimet e tyre janë të interesuara të mobilizojnë sa më shumë mjete të lira monetare dhe t'i shfrytëzojnë për dhënien e kredive.
- Niveli i depozitave ka rëndësi të veçantë për rrjedhat ekonomike. Ai jo vetëm që ndikon në rritjen e potencialit kreditor, por dhe në multiplikatorin e parasë. Multiplikatori ka lidhje pozitive me depozitat dhe lidhje inverse me rezervat e detyrueshme. Me fjalë të tjera, sa më shumë depozita dhe sa më të ulëta rezervat e detyrueshme, aq më i lartë multiplikatori dhe anasjelltas.

## Multiplikatori (shumëzuesi) monetar në një bankë të supozuar

	Aktiva		Pasiva	
Banka e I	Rezervat	1.000.000	Depozitat	1.000.000
	Kredit	900.000		
Banka e II	Rezervat	900.000	Depozitat	900.000
	Kredit	810.000		
Banka e III	Rezervat	810.000	Depozitat	810.000
	Kredit	729.000		
Banka e IV	Rezervat	729.000	Depozitat	729.000
	Kredit	656.100		
Banka e V	Rezervat	656.100	Depozitat	656.100
	Kredit	590.490		
Banka e .....	.....		.....	
Oferta e përgjithshme e parasë	10.000.000		10.000.000	

# KËRKESA PËR PARA

- ***Niveli i çmimeve*** - ka lidhje korelative me sasinë e parasë. Me fjalë tjera rritja e çmimeve rrit dhe kërkesën për para dhe anasjelltas.
- ***Të ardhurat reale*** - mund të rrisin ose të zvogëlojnë kërkesën për para. Lidhja pozitive tregon se rritja e të ardhurave rrit kërkesën për para dhe anasjelltas. Rritja midis tyre nuk është proporcionale.
- ***Norma e interesit*** - është faktor tjetër tejet ndikues në nivelin e kërkuar të parasë. Normat e larta të pritjes së interesit, rrisin kërkesën për para dhe anasjelltas.
- ***Pasuria***- rrit kërkesën për para dhe anasjelltas. Rritja e pasurisë mundëson konsumin më të lartë të mirave dhe shërbimeve i cili mund të sigurohet me anë të parasë.
- ***Risku- Likuiditeti i mjeteve alternative*** ka efekt të fuqishëm në kërkesën për para. Parat kesh kanë nivel të ulët të rrezikut sepse mund të merren në çdo kohë, përkundrazi parat e depozituara në periudhë afatgjatë kanë nivel të lartë rreziku.
- ***Bankomatet*** - ka lidhje inverse me kërkesën për para. Ekonomitë bashkëkohore karakterizohen me likuiditet të lartë të mjeteve monetare, sepse teknologjitë e avancuara mundësojnë transferim të shpejtë të mjeteve alternative në para të gatshme dhe anasjelltas.

# ROLI I BANKËS QENDRORE

- *Banka Qendrore, si institucion më i lartë monetar*
  - *Banka Qendrore, emiton para dhe rregullon ofertën për para*
- Sistemi i rezervave federale është sistemi qendror bankar në SHBA. Ai u themelua më 23 dhjetor të vitit 1913, me qëllimin e zbutjes së pasojave nga paniku financiar (1907).
- *Kongresi Amerikan, si themelues i rezervave federale kishte për objektiv:*
  - *stabilitetin e sistemit financiar,*
  - *rritjen e punësimit,*
  - *stabilitetin e çmimeve në periudhë afatgjatë,*
  - *rritjen e investimeve dhe hulumtimet e vazhduara në sferën e ekonomisë.*

# INSTRUMENTET MONETARE TË BANKËS QENDRORE

- - *politikën e rezervave të detyrueshme,*
  - - *politikën e tregut të hapur,*
  - - *politikën e normave diskontuese të interesit, dhe*
  - - *kontrolli i kredisë dhe normave*
- 
- **Rezervat e detyrueshme:** është operacion indirekt i Bankës Qendrore i kontrollit të ofertës monetare, janë pjesë e depozitave të bankave komerciale, të cilat nuk shfrytëzohen për të dhënë kredi, por ruhen te Banka Qendrore, ato janë të përcaktuara me ligj.

## BANKA QENDRORE EVROPIANE (ECB)

- ***Monedha e përbashkët ishte Euroja dhe të gjitha shtetet e BE-së të cilët përdornin këtë para në ekonomitë e tyre përbënin Eurozonën. Anëtarë të këtij bashkimi monetar në fillim ishin***
- njëmbëdhjetë shtete: Belgjika, Gjermania, Spanja, Franca, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Austria, Portugalia dhe Finlanda. Greqia u inkadrua më 1 janar të vitit 2001.
- Objektivi i Bankës Qendrore Evropiane ishte ndërtimi i politikës unike monetare e cila duhej të sigurojë zhvillim ekonomik me çmime stabile. Banka Qendrore Evropiane, funksionon me asistimin e bankave qendrore të ekonomive kombëtare, të cilat janë 12 dhe formojnë të ashtuquajturën eurosistem.

## Pyetje diskutimi!

- Çka nënkuptojmë me Inflacion?
- Çka shpreh norma e inflacionit?
- Prej kur është njohur inflacioni?
- Nga cila gjuhe vjen termi inflacion?
- Çka shpreh inflacioni?





INFLATION

- Për inflacionin janë dhënë definicione të ndryshme dhe gati të gjithë ekonomistët ***pajtohen se inflacioni rrit nivelin e çmimeve të të mirave dhe shërbimeve dhe zvogëlon vlerën e parasë. Siç do të shohim më vonë, raporti i tillë invers ndryshon për kah intensiteti dhe kohëzgjatja. Më poshtë prezantojmë pikëpamjet e disa ekonomistëve mbi inflacionin.***
- Sipas **Gjuro Raçiq**, me inflacion kuptojmë ata procese ekonomike të cilat krijohen dhe zhvillohen për shkak të rënies së vlerës së parave letër, e cila nënkupton zvogëlimin e vlerës reale të saj.
- ***Sipas Samulsonit, ekonomia ndodhet në inflacion kur niveli i*** përgjithshëm i çmimeve të të mirave dhe shërbimeve dhe kostot e tyre rriten (buka, gazi, makinat, sendet e patundshme, mëditjet etj.). Në deflacion çmimet e të mirave dhe shërbimeve dhe kostot e tyre bien.
- ***Në situata të tilla, sasi të tepër të larta të parave vrapojnë pas sasive tepër të vogla të të mirave dhe shërbimeve.***

- Ne praktike vine deri te **paraqitja e diferencës** midis ritmeve te rritjes se GDP reale me atë nominale, e cila ndodhe si rezultat i rritjes se çmimeve te mallrave ose thëne ndryshe ka pasur inflacion!
- **Norma e inflacionit** shpreh ritmin e rritjes, ne përqindje, te nivelit te çmimeve gjate një periudhe te dhëne.
- $NI = \frac{\text{niveli i çmimeve ne vitin}(t) - \text{niveli i çmimeve ne vitin } (t-1)}{\text{Niveli i çmimeve } (t-1)}$
- ***Niveli i çmimeve mund të matet dhe me indeksin e çmimeve të konsumatorit (CPI – Consumption Price Index). Ky indeks përfshin çmimin e të mirave dhe shërbimeve të domosdoshme për një familje 4 anëtarësh. Si të mira dhe shërbime të domosdoshme llogariten ushqimi, strehimi, përkujdesja shëndetësore, shkollimi etj.***

**Tabela 35 - Normat e inflacionit në shtetet e tranzicionit në vitet 1992, 2000, 2008, 2013 dhe 2014'**

	<b>1992</b>	<b>2000</b>	<b>2008</b>	<b>2013</b>	<b>2014'</b>
<b>Shqipëria</b>	236.6	0.1	2.2	2.7	1.9
<b>Krioacia</b>	938.2	6.2	6.1	2.2	2.0
<b>Estonia</b>	953.5	4.0	7.5	3.2	2.8
<b>Latvia</b>	959.0	2.6	10.6	0.0	2.0
<b>Lithuania</b>	1161.1	1.0	8.5	1.2	1.8
<b>Polo0nia</b>	79.4	9.9	7.2	0.5	1.4
<b>Bullgari</b>	44.3	10.1	4.2	0.8	2.0
<b>Polonia</b>	92.9	8.9	1.7	1.9	1.5
<b>Sllovenia</b>	92.9	8.9	1.7	1.9	1.5
<b>Armenia</b>	1341.0	- 0.8	5.2	5.8	3.9
<b>Azerbejxh.</b>	1395.0	1.8	15.5	2.5	3.8
<b>Bellorusia</b>	1559.0	168.6	13.3	18.3	14.5
<b>Gjeorgjia</b>	1176.9	4.1	5.5	- 0.5	4.1
<b>Moldavia</b>	2198.0	31.1	7.3	4.4	4.7
<b>Rusia</b>	2506.1	20.8	13.3	6.8	5.6
<b>Ukraina</b>	2730.0	28.2	22.3	- 0.3	2.8
<b>Maqedonia</b>	1935.0	5.8	4.1	2.8	2.1

- Për here te pare inflacioni u përdorë ne SHBA, për te shprehur rritjen e madhe te çmimeve dhe te qarkullimit te parës gjate kohës se luftës qytetare, (kur qeveria u detyrua te emitonte letra me vlere për te financuara luftën)
- Fjala inflacion vjen nga latinishtja “inflare”qe d.m.th buhmeje, fryrje, zmadhim etj.

## Definimi i inflacionit:

- Inflacionit si një dukuri komplekse ka qenë dhe është objekt studimi i shumë ekonomistëve.
- Inflacioni paraqet ngritje të vazhdueshme të nivelit të përgjithshëm të çmimeve.
- Ngritja e përgjithshme e çmimeve nënkupton ngritjen mesatare të çmimeve (ngase nuk mund të ngritën të gjitha çmimet në të njëjtën masë)!
- Atëherë lind pyetja si matet niveli i çmimeve?

- Niveli i çmimeve nga aspekti teorik dhe praktik matet nëpërmjet **tenderit mesatar te mallrave dhe shërbimeve** ne ekonomie e një vendi
- Niveli i përgjithshëm i çmimeve (inflacioni) matet me indeksin e **çmimeve te konsumit me pakice.**
- **Indeksi i konsumit me pakicë** mat shpenzimet e një shporte te mirave materiale (mallrave)dhe shërbimeve qe konsumon një familje gjate një periudhe te caktuar kohore, për një dite, një jave, një muaj etj.

# Çka përmban kjo shporte?

- Buke, vaj, kripe, sheqer, strehim, barna, kontrollin mjekësorë etj...
- Çka mendohet të ndodhe me sasinë e parave të treg, ka me shume oferte apo kërkesë?...



- Inflacioni paraqet situate kur ne treg ka me shume para se sa mallra.
- Andaj, me inflacion nënkuptojmë atë çrregullim monetar qe krijohet me lëshim ne qarkullim te një sasi me te madhe kartëmonedhash dhe te surrogate te parasë ne krahasim me sasinë e domosdoshme te realizimit te mallrave dhe shërbimeve.

## Deflator i bruto produktit shoqeror(GNP)

**Dallimi i vlerës nominale dhe reale te GNP quhet deflatori i GNP!**

- Si paraqitet kjo dukuri?
- Vlera absolute e GNP nominale rritet me shpejte se vlera absolute e GNP reale, si rezultat i rritjes se çmimeve (inflacionit) qe rritet për çdo vit.

# Si llogaritet matematikisht deflatori i GNP?

- Deflatori i GNP=  $\text{GNP nominale} / \text{GNP reale} * 100$
- Indeksi i çmimeve te prodhuesit – mat nivelin e çmimit te shitjes me shumice apo ne fazën e prodhimit.

Cilët llojet te inflacionit i njiheni?

# Llojet e inflacionit:


- **Inflacioni i moderuar** (përmbajtur)- rritje e ngadalshme, norme njeshifror
- **Inflacioni galopant** - për dallim nga inflacioni i moderuar ky inflacion karakterizohet me nivele te larta mesatare te çmimeve gjate një viti.
- **Hiperinflacioni**-cregullimi i çdo procesi ekonomik.

# INFLACIONET TË SHKAKTUARA NGA KËRKESA DHE OFERTA AGREGATE

- Ngritja e nivelit mesatar të çmimeve do të shoqërohet me ngritjen e pagave të cilat do të nxisin akoma më shumë inflacionin.
- *Rritja e njëjtë e nivelit mesatar të çmimeve nga viti në vit quhet inflacion inercial, i pritshëm ose i parashikuar.*
- *Kjo dukuri në ekonomi njihet si spiralja çmim-pagë-inflacion, ky i fundit rritet në formën e shkallëve dhe emërtohet si rritja e shkallëzuar e inflacionit.*

# Grafiku 28


## Inflacioni i inicuar nga rritja e kërkesës



- Zhvendosja e kurbës së kërkesës agregate afatshkurtër djathtas pozicionit të saj fillestar, nga SAD0 në SAD1 mund të nxitet nga shumë faktorë, por rritja e shpenzimeve qeveritare dhe e ofertës së parasë janë më të rëndësishmit. Për prezantimin e grafikut 28, i referohemi një shembulli konkret. Supozojmë se në vitin 2013, niveli mesatar i çmimeve (inflacioni) të të mirave dhe shërbimeve ka qenë 100 \$ dhe PBB real 10 miliard \$, po aq ka qenë dhe PBB potencial, i cili prezantohet në kurbën vertikale me ngjyrë të kuqe (LAS). Kurba e kërkesës dhe ofertës agregate në periudhën afatshkurtër janë shënuar me SAS0 respektivisht SAD0, të cilat priten në pikën E0.

# Grafiku 29

Rritja e shkallëzuar e nivelit mesatar të çmimeve (inflacionit)






- Oferta e zvogëluar (SAS0 në SA1) shoqërohet me rritjen e nivelit mesatar të çmimeve nga P0 në P1, kurba e së cilës pritet me kurbën e kërkesës agregate SAD1 dhe ekonomia zhvendoset në një ekuilibër të ri E1, në të cilën PBB nominal është kthyer në nivelin e PBB potencial dhe rritje ka shënuar vetëm normat e inflacionit nga P0 në P1. Por nëse kurba e kërkesës agregate zhvendoset vazhdimisht djathtas e nxitur nga rritja e shpenzimeve qeveritare ose rritja e ofertës monetare atëherë ekonomia kalon në ***inflacion të vazhdueshëm nga kërkesa***

# Grafiku 30


## Inflacioni i vazhdueshëm nga kërkesa



- Rritja e vazhduar e kërkesës agregate në situata kur PBB real vazhdon të tejkalojë atë potencial, do të rezultojë me rritjen e pagave, të cilat duke rrit koston e prodhimit do të reduktojnë ofertën agregate. Kurba e saj zhvendoset majtas pozicionit fillestar nga AS1 në AS2 dhe niveli mesatar i çmimeve do të rritet nga 150 në 200 \$. Siç mund të vërejmë nga grafiku 30, çdo ekuilibër i ri, E0, E1 respektivisht E2 në nivelin e PBB potencial rezulton me inflacion të rritur prej 100, 150, respektivisht 200 \$.

# Grafiku 31

## Inflacioni nga kostoja



- Nga grafiku i mësipërm, mund të vërehet se rritja e kostove rezulton me uljen e ofertës agregate (kurba e saj zhvendoset majtas nga AS0 në AS1) dhe me rritjen e nivelit mesatar të çmimeve nga P0 në P1. Ekonomia gjithnjë e më shumë largohet nga potenciali prodhues e cila mund të vërehet nga zhvendosja e pozitës ekuilibruese nga E0 në E1 e shoqëruar me norma të larta të inflacionit dhe papunësisë. Me fjalë të tjera, inflacioni dhe papunësia bashkekzistojnë.

# Pasojat e Inflacionit:

- Ndikimi ne te ardhurat dhe shpërndarja e pasurisë!
- Ndikim ne outputin dhe ne efikasitetin (eficencen )ekonomike!
- Pasojat ne papunësi...

# Shkaqet e inflacionit

- Inflacioni inercial (thelbësor)- qe kyçet ne kontrata dhe aranzhmane!

Ndryshe quhet inflacion i paparashikueshëm

- Inflacioni nga kërkesa

Spiralja çmim-page-inflacion(CPI)

- Inflacioni nga kostoja(oferta)



**1972**



**1992**



**2012**



## DEZINFLACIONI DHE REFLACIONI


- ***Dezinflacioni korrigjon vlerën e brendshme të parasë dhe ka objektiv*** frenimin e inflacionit. Ai pengon inflacionin, por nuk lejon që ekonomia të futet në deflacion. Efektet shoqëruese të dezinflacionit janë: zvogëlimi i normës së interesit, tkurrja e buxhetit qeveritarë, ngrirja e nivelit të të ardhurave të punëtorëve etj.
- ***Reflacioni është masë korrigjuese e vlerës së parasë dhe ka për objektivë*** frenimin e deflacionit. Ai pengon deflacionin, por nuk lejon që ekonomia të futet në inflacion. Për nga veprimi reflacioni është shumë më afër inflacionit, masat që aplikohen në reflacion janë: lehtësimi i kushteve për marrjen e kredive, politika ekspansive fiskale etj.

# RAPORTI I INFLACIONIT DHE PAPUNËSISË

- Kërkuesit e politikave ekonomike me masat që kanë në dispozicion luftojnë dukuritë të cilat destabilizojnë ekonominë. Kemi cek më parë se papunësia dhe inflacioni janë problem serioze ekonomike dhe kërkuesit e politikave ekonomike luftojnë si njërin ashtu dhe dukurinë tjetër. ***Në luftën kundër tyre është me rëndësi të njëhet efekti ekonomik i inflacionit, kur qeveria merr masa kundër papunësisë dhe anashjelltas.***

# Grafiku 32

## Kurba e Philipshit, raporti papunësi - inflacion



- Siç mund të vërehet nga grafiku 32, pikët A, B dhe C formojnë kurbën e Filipsit, secila pikë tregon se me rritjen e normave të papunësisë nga 4, 8, respektivisht 12 %, normat e inflacionit bien nga 9 në 6, respektivisht 3 %. Kurba e ka marrë emrin sipas autorit dhe tregon se me politikat ekonomike nuk mund të luftohen sëbashku të dy dukuritë, por nëse luftohet inflacioni lihen anash papunësia dhe anashjelltas.
- Raportet papunësi - inflacion, ndryshojnë sjelljet në periudha të ndryshme kohore, prandaj kurba e Filipsit analizohet në periudhë afatshkurtë dhe afatgjatë.


# Teoria bashkekohore e inflacionit

## Kurba e Filipsit

- Dy objektiva kryesore makroekonomike
  - stabiliteti i çmimeve
  - zvogëlim i papunësisë
- Ne periudhe afatshkurtër
- Ne periudhe afatgjate
- Çka ndodhe me lidhshmërinë norme inflacioni dhe papunësi...

### Grafiku 33


### Kurba e Philipsit në periudhë afatshkurtër



- Në grafikun 33 pika A tregon norma natyrore të papunësisë prej 4 % dhe inflacionit të pritshëm prej 6 %. Nëse norma e inflacionit inercial rritet, norma natyrore e papunësisë bie (pika B) dhe anasjelltas (pika C). Kurba e Filipsit është ndërtuar në bazë të të dhënave empirike të papunësisë dhe inflacionit në ekonominë angleze në vitet 1950 dhe 1960, që mund ta vërejmë nga grafiku i mëposhtëm.

## Grafiku 34

Kurba e Filipsit në bazë të të dhënave të ekonomisë angleze të viteve 1950 dhe 1960






- Kurba e Filipsit në periudhën afatgjatë bëhet plotësisht jo elastike (pozitivë vertikale), në nivelin e normës natyrore të papunësisë, ashtu si në grafikun 35. Nga grafiku mund të vërehet se Kurba e Filipsit në periudhën afatgjatë është derivuar nga kurbat afatshkurta të cilat kalojnë në 4 pika, ato janë: pika A në të cilën ekonomia është në normën natyrore të papunësisë dhe nuk ka goditje as nga oferta dhe as nga kërkesa. Pika B prezanton rritje më të shpejtë të ekonomisë e cila shoqërohet me norma të larta të inflacionit dhe papunësi të ulët. Pika C tregon ekonominë me norma të njëjta të papunësisë, si në pikën B, por me norma më të larta të inflacionit. Inflacioni në rritje rezulton nga indeksimi i pagave dhe çmimeve të të mirave dhe shërbimeve, sepse punëtorët dhe firmat e biznesit fillojnë të parashikojnë inflacionin dhe të marrin masa mbrojtëse. Pika D tregon rikthimin e PBB në kufijtë e tij potencial, si dhe rikthimin e papunësisë në normat e saj natyrore. Siç mund të vërehet nga grafiku, në këtë nivel prodhimi, ekonomia shoqërohet me inflacion të rritur (pika A dhe D).

# Grafiku 35


## Kurba e Filipisit në periudhë afatgjatë



- Në vitet 1967 dhe 1968 ekonomistët Edmund Pheleps dhe Milton Friedman, befasuan opinionin botëror kur dhanë argument se Kurba e Philipsit është vetëm një fantazi, pa asnjë bazë shkencore. Sipas tyre kurba e Philipsit tregon vetëm një raport invers të papunësisë dhe inflacionit për vitet 1950 dhe 1960, por ajo nuk ka kurrfarë rëndësie për të ardhmen. Ekonomistët e lartpërmendur vërtetuan se oferta monetare mund të krijojë kombinime të ndryshme të normave të papunësisë dhe atyre të inflacionit, të cilat mund të kenë edhe lidhje të forta korelative mes veti. Ajo mund të vërehet nga prezantimi i grafikut të mëposhtëm.

Grafiku 36

Kurba e Philipsit në bazë të të dhënave të ekonomisë angleze të viteve të 70 - ta



Per çdo paqartësi dhe pyetje ju lutem me kontaktoni në email adresën:

[merale.fetahi@unite.edu.mk](mailto:merale.fetahi@unite.edu.mk)